

KA.nr.1023/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVES, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Biljana Rexhiq dhe Dalip Bega anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti-procesmbajtëse, duke vendosur sipas ankesës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes, Nr.Regj.62590/2012 të dt.30.08.2013, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 dhe 222 të Ligjit për Kundërvajtjet, më dt. 25.09.2013, merr këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e BAZUARA.

ABROGOHET aktvendimi për Hudhjen e Kërkesës i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtje, Nr.Regj.62590/2012 të dt.30.08.2013, dhe lënda i kthehet i Gjykatës së shkallës së parë për inicimin e procedurës kundërvajtëse dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

I. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes, me aktvendim, Nr.Regj.62590/2012 të dt.30.08.2013, e ka Hudhë, Kërkesën, me nr.01-4248 të dt. 23.11.2012 e paraqitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit, ndaj Ibrahim Çunakut, nga fsh. Drenoc – Prishtinë, për kundërvajtje nga nenet 5,6 par.1.1, neni 7, 9 dhe 17 al.1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar, konform nenit 135 al.4 të Ligjit për Kundërvajtje.

Kundër këtij aktvendimi Agjencia Kundër Korrupsionit ka paraqitur ankesë, për shkak të vendimit lidhur me rastin e iniciuar me arsyetim se AKK e ka pranuar me datë 27.05.2013 kërkesën për plotësim nga Gjykata Themelore në Prishtinë Divizioni për Kundërvajtje. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë Agjencia me datë 29.05.2013 e ka kthyer përgjigjen me shkresë zyrtare me numër të protokollit 01-1592 dhe i është përgjigjur gjykatës në të gjitha informacionet e kërkuara, si dëshmi për këtë e kemi fletë kthimin nga Posta e Kosovës. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqiptuar dënimin e merituar edhe përkundër të gjitha fakteve të ofruara, e ka hudhë kërkesën me arsyetim se nuk i kemi evituar mangësitë në afatin ligjor. Si dëshmi ankesës ia bashkëngjit Përgjigjen në kërkesë dhe Fletë kthimin nga PTK-ja.

Kolegji pas shqyrtimit të thënieve në ankesën e parashtruar, aktvendimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit është e bazuar.

Kolegji pas shqyrtimit të thënieve në ankesë, aktvendimin e goditur si dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se Gjykata e shkallës së parë pa të drejtë e ka hudhë kërkesën për hapjen e procedurës kundërvajtëse, për shkak sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë. Nga shkresat e lëndës është konstatuar se gjykata e shkallës së parë me dt. 24.05.2013, iu ka drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me Kërkesë që ta bëjë plotësimin e Kërkesës për hapjen e procedurës kundërvajtëse e ngritur kundër të pandehurit Ibrahim Qunaku nga Prishtina, i cili është

ngarkuar për kundërvajtje nga neni 5,6 par.1.1, 7, 9 dhe neni 17 par. 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar. Agjencia iu ka përgjigjur kërkesës së gjykatës për Plotësim, me dt.29.05.2013, gjë që konstatohet në bazë të referencës nr.01-1592/2013 të dt.29.05.2013 të bashkangjitur shkresave të lëndës. Nga kjo konstatohet se Agjencia në afatin ligjor brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për plotësim, e ka plotësuar të njëjtën me shënimet e kërkuara nga gjykata.

Në bazë të cekurave më lartë konstatohet se gjykata e shkallës së parë pa bazë ligjore e ka hudhë Kërkesën për hapjen e procedurës kundërdvajtëse, andaj për këtë arsye ankesa e parashtruar nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsionit është e bazuar kurse aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë abrogohet dhe lënda i kthehet për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës kundërvajtëse dhe rivendosje.

Në plotësim të procedurës gjykata e shkallës së parë duhet të kryej këto veprime procedurale, që të merr konkluzion për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, ti ftojë palët në procedurë dhe pas nxjerrjes së të gjitha provave të mundshme dhe vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të nxjerr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në vështrim të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.


Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

KA nr. 1023/2013 të dt.25.09.2013

Bashkëpunëtorja,

Sebahate Hoti



KRYETARJA E KOLEGJIT,

Rejzime Zekaj